

1 E premte, 5 mars 2021

2 [Konferencë për Ecurinë e Çështjes]

3 [Seancë e hapur]

4 [I akuzuari nuk është i pranishëm]

5 --- Fillon në orën 11.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita të gjithëve brenda dhe  
7 jashtë sallës së gjyqit.

8 Znj. Sekretare e Gjykatës, ju lutem shpallni çështjen.

9 SEKRETARJA I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, z. Gjykatës.  
10 Kjo është çështja KSC-BC-2020-05, Prokurori i Specializuar kundër  
11 Salih Mustafës.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare e  
13 Gjykatës.

14 Tani u lutem palëve që të prezantohen, duke filluar nga Zyra  
15 e Prokurorit të Specializuar.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëdita, z. Gjykatës. Mirëdita të  
17 gjithëve. Prokuroria sot prezantohet nga Alex Whiting,  
18 Zëvendësprokuror i Specializuar; nga unë, Cezary Michalczuk,  
19 prokuror; Filippo de Minicis, ndihmësprokuror; Silvia D'Ascoli,  
20 ndihmësprokurore; si edhe Line Pedersen, menaxhere e Çështjeve dhe  
21 e Provave. Faleminderit, z. Gjykatës.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

23 Tani ia kaloj fjalën Mbrojtjes.

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëdita, z. Gjykatës. Mbrojtja sot  
25 përfaqësohet nga unë, Julius von Bone, kryembrojtësi. I akuzuari

1 nuk është i pranishëm dhe për këtë kemi dhënë informacion. Dhe në  
2 distancë janë disa anëtarë të ekipit tim, Betim Shala; dhe Fatmir  
3 Pelaj, është hetues; si edhe një tjetër zotëri, Avdi Mehmeti do të  
4 na bashkohet më vonë si anëtar i ekipit të Mbrojtjes kur të jetë  
5 bërë dhe dokumentacioni i duhur. Faleminderit.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Von Bone.

7 Unë për hir të procesverbalit do të përmend që nuk janë të  
8 pranishëm në sallën e gjyqit, por na ndjekin në distancë.

9 Për hir të procesverbalit, jam Nicolas Guillou, Gjykatës i  
10 Procedurës Paraprake.

11 Më datë 17 shkurt kam caktuar seancën e pestë për Konferencën  
12 e Ecurisë së Çështjes. Objektivi sot është që të shqyrtojmë  
13 ecurinë e kësaj çështje dhe të organizojmë hapat e fundit  
14 procedural përpara kalimit të dosjes gjyqësore Trupit Gjykues.

15 Vë re se nuk janë depozituar asnjë parashtrim me shkrim nga  
16 asnjëra prej palëve. Do t'u lutem palëve të bëjnë parashtrimet e  
17 tyre mbi këto tema sipas Urdhrit të Caktimit të Seancës: Së pari,  
18 mbi nxjerrjen e materialeve, pastaj mbi hetimet, pastaj mbi  
19 kalendarin për pjesën tjetër të mbetur të procedurës paraprake.

20 Si zakonisht, i kujtoj palët që të na informojnë paraprakisht  
21 nëse parashtrimet e tyre kërkojnë nxjerrjen e informacioneve  
22 konfidenciale në mënyrë që të kalojmë në seancë private apo të  
23 mbyllur.

24 Megjithatë, përpara se të fillojmë me pikën e parë të rendit  
25 të ditës, dëshiroj që të falënderoj palët për parashtrimet e

1 përbashkëta rbashkëta mbi një version më pak të redaktuar të  
2 transkriptit të Konferencës së tretë mbi Ecurinë e Çështjes, të  
3 depozituar më datë 15 shkurt 2021. Është parashtrimi i  
4 protokolluar me numër F79.

5 Në bazë të kësaj, jap këtë urdhër gojarisht:

6 Sekretarja të përgatisë një version më pak të redaktuar të  
7 transkriptit të Konferencës së tretë mbi Ecurinë e Çështjes të  
8 zhvilluar më datë 14 dhjetor 2020, dhe do të mbahen redaktimet  
9 vetëm mbi segmentet e mëposhtme: Rreshtat 11, 12, në faqen 97;  
10 rreshtat 17 deri 23, në faqen 100; rreshtat 19 deri 25, në faqen  
11 101; rreshtat 1 deri 11 dhe rreshtat 18 deri 25, në faqen 102; dhe  
12 rreshtat 11 deri në 19, në faqen 103. Të gjitha redaktimet e tjera  
13 hiqen.

14 Dua të kalojmë tani në seancë private shkurtimisht për të  
15 diskutuar me palët për një depozitim të protokolluar kohët e  
16 fundit.

17 Znj. Sekretare, ju lutem na informoni kur kemi kaluar në  
18 seancë private.

19 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Z. Gjykatës, jemi në seancë  
20 private.

21 [Seancë private]

22 [Seancë e mbyllur tekst i fshirë]

23

24

25

1 [Seancë e mbyllur tekst i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25 [Seancë e hapur]

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

2 E fundit përpara se të fillojmë me rendin e ditës, do të doja  
3 të pyesja prokurorin nëse synon që të depozitojë një version të  
4 redaktuar publik të dosjes paraprahe të Prokurorisë, dhe nëse po,  
5 kur?

6 Z. MINICIS: [Përkthim] Z. Gjykatës, he për he dhe për arsye  
7 që kanë të bëjnë me mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të viktimave,  
8 Prokuroria nuk planifikon të depozitojë një version publik he për  
9 he, por nëse ju kërkoni që ta bëjmë një gjë të tillë, ne do ta  
10 bëjmë sa më shpejt që të jetë e mundur.

11 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

12 Z. Von Bone, doni të thoni ndonjë gjë?

13 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk kam asnjë kundërshtim sa i takon  
14 depozitimit jopublik nëse Prokuroria dëshiron që të vijojë kështu.  
15 Ne si Mbrojtje s'kemi kundërshtim për këtë.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Von Bone.

17 Kalojmë tani në pikën e parë të rendit të ditës, që është  
18 pyetja nëse ZPS-ja e ka përfunduar nxjerrjen e materialeve  
19 provuese, përfshirë edhe materialet shfajësuese. Dhe nëse jo, edhe  
20 sa materiale mbeten për t'u nxjerrë; në bazë të cilës rregull do  
21 të nxirren këto materiale; deri kur synon ZPS-ja që t'i nxjerrë  
22 këto materiale; cilat janë arsyet për vonimin në nxjerrje; dhe  
23 nëse nevojiten apo jo masa mbrojtëse dhe për sa dëshmitarë.

24 Dëshiroj t'i kërkoj Prokurorit që të bëjë të ditur nëse ZPS-  
25 ja vijon të ketë në ruajtje, kontroll, apo në dijeni faktike prova

1 shfajësuese të cilat i duhen bërë me dije Mbrojtjes në bazë të  
2 rregullës 103 të Rregullores.

3 Z. Prokuror, keni fjalën.

4 Z. MINICIS: [Përkthim] Faleminderit, z. Gjykatës.

5 ZPS-ja e ka përfunduar nxjerrjen e provave dhe nuk parashikon  
6 nxjerrje provash të tjera, me përjashtim të provave që mund të  
7 dalin nga aktivitetet hetimore për të cilat e kemi informuar z.  
8 Gjykatës sot në mëngjes përmes dokumentit *ex parte*.

9 Lidhur me provat shfajësuese, dje i kemi vendosur në  
10 dispozicion Mbrojtjes, sipas vendimit të datës 1 mars të këtij  
11 viti të z. Gjykatës, materialet e shtojcës 1 të kërkesës së datës  
12 15 shkurt për redaktimet dhe nxjerrjen me vonesë.

13 Shtojca 2 e materialeve në fjalë të kërkesës është autorizuar  
14 nga ju si Gjykatës lidhur me vonesën. Prandaj dhe ky është i vetmi  
15 material i rregullës 103 që ende nuk është nxjerrë nga Prokuroria.

16 Me përjashtim të kësaj, Prokuroria e ka kryer detyrimin e vet  
17 sa i takon provave shfajësuese që ka në ruajtje apo në dijeni.  
18 Sigurisht, ne gjithmonë do ta mbajmë parasysh detyrimin tonë në  
19 vijimësi lidhur me këtë aspekt, dhe nëse prova të tjera  
20 shfajësuese na vinë në dijeni, do ta informojmë Mbrojtjen dhe do  
21 t'ia vendosim në dispozicion Mbrojtjes pa vonesë.

22 Kaq kisha, z. Gjykatës.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

24 Z. Von Bone.

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Ma merr mendja që Prokuroria flet për

1 nxjerrjen numër 35 që e kemi marrë dje?

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Prokuror.

3 Z. MINICIS: [Përkthim] Po, z. Von Bone.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk ka gjë tjetër që do të na jepni?

5 Z. MINICIS: [Përkthim] Jo. Jo, he për he. Mbase, lidhur me  
6 këtë, lidhur me aktivitetin hetimor për të cilin kemi folur më  
7 herët, mund të ketë disa dokumente sipas rregullës 103 që  
8 Gjykatësi i Procedurë Paraprake na ka lejuar që t'i nxjerrim më  
9 vonë.

10 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirë, në rregull. E kuptoj. Pa  
11 problem.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Von Bone, keni ndonjë  
13 vërejtje të përgjithshme lidhur me procesin e nxjerrjes së  
14 materialeve dhe ndonjë vështirësi që keni hasur?

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Von Bone.

17 Kalojmë tani te pika e dytë e rendit të ditës që ka të bëjë  
18 me ecurinë e hetimeve. Do të doja që Prokuroria të na tregojë nëse  
19 i ka kryer hapat e vet hetimor. Nëse jo, nëse mund të na japë një  
20 afat.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Z. Gjykatës, ZPS-ja i ka përfunduar  
22 hetimet e veta. Ka vetëm dy aktivitete hetimore ende të  
23 papërfunduara që kanë mbetur. E kemi diskutuar njërin prej tyre në  
24 seancën private, dhe kemi depozituar dhe një dokument të  
25 protokolluar sot në mëngjes. Ju jeni plotësisht i informuar për

1 këtë për të cilën po flas tani.

2 Tjetra, pra, një aktivitet tjetër i papërfunduar hetimor  
3 është plotësisht në dijeninë tuaj z. Gjykatës, sepse ne kemi bërë  
4 disa parashtrime të protokolluara në të shkuarën. Këto dy  
5 aktivitete nuk e pengojnë fare gatishmërinë për ta kaluar çështjen  
6 në proces gjyqësor. Pra, ne jemi gati për të filluar procesin  
7 gjyqësor.

8 Në Konferencën e fundit mbi Ecurinë e Çështjes, për shkak  
9 edhe të çështjeve të tjera që kemi në duar, çështje të tjera  
10 gjyqësore që kemi nëpër duar, kemi filluar që të bëjmë disa  
11 aktivitete hetimore lidhur me to, dhe në bazë të tyre mund të  
12 dalin materiale të cilat mund të kenë lidhje dhe me këtë çështje  
13 gjyqësore. Por nëse zbulohen materiale të tilla, ne menjëherë dhe  
14 plotësisht do të përmbushim detyrimet tona për nxjerrjen e  
15 materialeve në dispozicion të Mbrojtjes. Dhe, përsëris, kjo nuk  
16 cenon gatishmërinë tonë për proces gjyqësor në këtë çështje  
17 gjyqësore.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

19 Tani ia jap fjalën Mbrojtjes.

20 Z. Von Bone, mund të na jepni një informacion më të fundit  
21 lidhur me hetimet tuaja? Në veçanti, do të doja që Mbrojtja të na  
22 bënte me dije një datë të parashikuar të përfundimit të këtyre  
23 hetimeve, së pari mbi alibinë dhe pastaj mbi pjesën tjetër të  
24 hetimeve të Mbrojtjes.

25 Fjala për ju.



1           Z. VON BONE: [Përkthim] I nderuar z. Gjykatës, Mbrojtja  
2 sigurisht e ka parë kalendarin paraparak që na propozon z.  
3 Gjykatës, dhe me njëfarë çlirimi shohim diçka, vërejmë diçka. Pse  
4 e them këtë? Është se data 6 prill, që është tani afati i  
5 propozuar për njoftimin e alibisë, mendoj se është thujtë në mes  
6 të periudhës gjatë së cilës ne do të konstatojmë alibinë. Do të  
7 njoftojmë faktikisht ZPS-në kur ta kemi pak a shumë të plotësuar.

8           Besojmë që gjatë atij muaji, me shumë gjasë do të kemi disa  
9 dëshmitarë të tjerë të alibisë, dhe mendoj se do të kemi ecur  
10 përpara dhe me përgatitjen e dosjes paraprake. Prandaj dhe shtyrja  
11 e këtij afati më datë 6 prill, që është pas Pashkëve, do të jetë  
12 disi e vështirë për t'u përmbushur nga Mbrojtja.

13           Megjithatë, është dhe një afat tjetër që është data 18 mars,  
14 që ka të bëjë me kërkesën për masa mbrojtëse. Siç qëndrojnë gjërat  
15 tani, pra, siç qëndrojnë gjërat sot, unë nuk besoj se në fakt do  
16 të kërkonim masa mbrojtëse. Megjithatë, unë nuk mund të parashikoj  
17 se çfarë mund të ndodhë gjatë punës sonë, sepse do të jetë një  
18 punë e gjatë. Por do të sugjeroja që ta shtynim këtë afat më tutje  
19 në kohë, por përpara afatit për dosjen paraprake. Po ta vendosja  
20 unë, unë do të doja të kërkoja për 16 prillin, meqenëse kjo është  
21 data për dosjen paraprake, nëse mund ta kalojmë më datë 30.

22           Unë e kam parë që më datë 30 ju propozoni kalimin e dosjes  
23 gjyqësore Trupit Gjykues, por unë mendoj se gjatë atij muaji ne  
24 pak a shumë do të jemi në gjendje që të përfundojmë pjesën më të  
25 madhe të kësaj dosjeje, të dosjes sonë paraprake.

1 Prandaj unë mendoj, për hir të efikasitetit dhe për hir të  
2 plotësisë së dosjes paraprake, dosjes tonë paraprake, do të ishte  
3 më e dobishme që të shtyhej ky afat siç e propozojmë ne.

4 Sa i takon Konferencës mbi Ecurinë e Çështjes, konferencën e  
5 ardhshme, mendojmë se nga fillimi i majit do të ishte e dobishme.  
6 Me shumë gjasë edhe anëtarët e tjerë të ekipit do të jenë në  
7 gjendje që të jenë të pranishëm në atë seancë, përfshirë këtu edhe  
8 klientin tim, për të pasur kështu një pamje të plotë të çdo  
9 çështjeje tjetër të mbetur pezull asokohe.

10 Në thelb pra, ajo që kërkojmë është që afati i njoftimit i  
11 cili është propozuar për datë 6 prill, dhe që për mendimin tonë  
12 konsiderohet se është shumë herët, mund të jetë më datë 16 prill,  
13 ose mund të jetë njëkohësisht me depozitimin e dosjes tonë  
14 paraprake për të qenë e plotë. Megjithatë, kjo është e hapur për  
15 diskutim. Unë jam i hapur për ta diskutuar, por unë kërkoj një  
16 shtyrje me dy javë nëse është e mundshme.

17 Kjo i jep mundësi Mbrojtjes që muajin prill dhe muajin mars  
18 ta përdorë për këtë gjë, sepse misioni ynë i ardhshëm fillon jo  
19 këtë javë, po javën e ardhshme, e kjo do të na japë mundësi që të  
20 arrijmë njëfarë përfundimi.

21 Unë e di që dosja paraprake mund të ndryshohet, mund të  
22 shtohen edhe dëshmitarë të tjerë, por siç qëndrojnë gjërat kë për  
23 kë, disa prej dëshmitarëve nuk janë disponibël. Prandaj do të  
24 ishte e dobishme që ta shtynim paksa në kohë.

25 Këtë kërkojmë, z. Gjykatës.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Von Bone.

2 A mundet që të na jepni datën e misionit tuaj të ardhshëm në  
3 Kosovë?

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Hë për hë planifikojmë nga data  
5 19 mars deri më datë 5 prill, prandaj dhe data 6 prill është shumë  
6 e vështirë. Prandaj nëse e vendosim në mes të prillit, atëherë na  
7 jep disi kohë, qoftë edhe për të parë nëse kemi nevojë për masa  
8 mbrojtëse. Prandaj edhe unë kërkoj njëfarë shtyrje.

9 Pastaj, më datë 5 prill, misioni tjetër i ardhshëm mund të  
10 jetë nga data 16 prill deri më datën 23 prill. Do të përpiqemi që  
11 të bëjmë njëlloj finalizimi së bashku me ekipin dhe me personat që  
12 kërkojmë si dëshmitarë të alibisë ashtu edhe dëshmitarë jo të  
13 alibisë, që t'i përfshijmë në dosjen tonë paraprake.

14 Kështu qëndrojnë gjërat sot për sot, z. Gjykatës.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] A mendoni se mund ta finalizoni  
16 aktivitetin tuaj hetimor gjatë misionit tuaj të ardhshëm/të parë  
17 pra?

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Dhe prandaj na duhet pak më shumë  
19 kohë në fakt. Mbase mund të kemi një dëshmitar alibie i cili nuk  
20 jeton në Kosovë, është jashtë shtetit, dhe i takon që ndoshta ai  
21 do të trajtohet në misionin e tretë, ose nuk do të trajtohet fare,  
22 d.m.th., në varësi të mënyrës sesi do të vazhdojë procesi.

23 Megjithatë, pavarësisht kësaj, pa diskutim që ne do të  
24 vazhdojmë pak me dëshmitarët. Megjithatë, aktualisht përparësia  
25 është në këtë periudhë kohore që unë ju shpjegova pak më parë,

1 edhe kjo është arsyeja sepse misioni do të zgjasë dy javë.

2 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Von Bone.

3 Ndërkohë tani kalojmë te pika tjetër e programit, e rendit të  
4 ditës për sot.

5 Siç e dini z. Von Bone, unë kam propozuar një kalendar për  
6 pjesën e procedurave të tjera të gjykimit paraprak, duke marrë  
7 parasysh faktin që ZPS-ja ka tashmë një dosje paraprake, ka një  
8 listë të dëshmitarëve dhe listë të provave materiale, dhe që  
9 Mbrojtja është në procesin e përfundimit të hetimeve të saj në  
10 javët në vijim.

11 Tani do të doja t'u kërkoja palëve që të shpreheshin se çfarë  
12 pikëpamjesh, çfarë mendimesh kishin për kalendarët, për kalendarin  
13 e propozuar. Z. Von Bone u shpreh. Dhe në veçanti, unë do të doja  
14 t'u kërkoja palëve që të më shprehen lidhur me datën sa i takon  
15 Urdhrit për Përcaktimin e Seancës:

16 Pra, për të përcaktuar datën 18 mars 2021, të enjten, si  
17 afatin kohor për Mbrojtjen për të dhënë -- për të parashtruar  
18 kërkesa për masa mbrojtëse;

19 Ndërkohë, parashikoj datën 6 prill 2021, si kohën për t'i  
20 bërë të mundur Mbrojtjes për të njoftuar ZPS-së për alibinë e saj,  
21 ose për të nxjerrë materialet përkatëse të cilat lidhen me  
22 rregullën 104(1) të Rregullores;

23 Datën 6 prill 2021, për afatin kohor të propozuar për  
24 Mbrojtjen për kërkesa për masa paraprake, për masa mbrojtëse dhe  
25 për dëshmitarë jo alibi;

1 Ndërkohë, propozoj po ashtu dhe datën 16 prill 2021, për  
2 datën e propozuar për Mbrojtjen për dosjen paraprake dhe për  
3 materialet e tjera të lidhura me rregullën 95(5) të Rregullores;

4 Dhe parashikoj gjithashtu edhe datën 30 prill 2021, në varësi  
5 të kërkesave të palëve për sa i takon çështjeve të mbetura pezull  
6 dhe që ata i propozoj -- dhe i mendojnë të rëndësishme.

7 D.m.th., ky është kalendari që unë propozoj. Z. Von Bone,  
8 juve sa na përmendët disa data që ju propozoni që të hiqen nga ky  
9 kalendar paraprak. Kështu që do të doja t'i jepja fjalën tani ZPS-  
10 së që të komentonte mbi datat që unë sa thashë, sa përmenda.

11 Atëherë, duke pasur parasysh atë çfarë tha z. Von Bone dhe  
12 propozimet që parashtrova unë, çfarë mund të na thoni, i nderuar  
13 Prokuror?

14 Z. MINICIS: [Përkthim] Faleminderit.

15 Siç u tha edhe prej jush, i nderuar Gjykatës, pra, duhet që  
16 të respektohet rregulla 109 pra, dhe Prokuroria në vetvete nuk  
17 është se ka ndonjë kundërshtim sa i takon ndryshimit apo  
18 përshtatjes së kalendarit për t'iu përgjigjur nevojave të  
19 Mbrojtjes për hetime.

20 Megjithatë, Prokuroria dëshiron që datën 30 prill, ose një  
21 datë shumë të afërt me datën 30 prill duhet -- ne propozojmë që të  
22 mbahet si data për dërgimin e dosjes gjyqësore përpara Panelit  
23 Gjyqësor. D.m.th., në qoftë se data 30 prill, nuk është e mundur  
24 fiks në atë datë, atëherë do të propozonim një datë e cila është  
25 sa më afër kësaj date.

1 Nuk kemi ndonjë kundërshtim dhe thjesht ju propozojmë, i  
2 nderuar Gjykatës, që ta mbani këtë propozim tonin parasysh.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Prokuror.

4 Z. Von Bone, atëherë, le t'i kalojmë njëra pas tjetrës të  
5 gjitha afatet kohore që të jemi pak më të qartë.

6 Sa i takon afatit kohor që juve do të urdhëroheni që të  
7 njoftoni ZPS-së për alibinë që përmendët, unë propozoj datën 6  
8 prill që është ditë e martë. Çfarë dite do të ishte e përshtatshme  
9 për juve, duke pasur parasysh hetimet tuaja dhe duke marrë  
10 parasysh faktin që ju do të ktheheni nga Kosova më datën 5?

11 Z. VON BONE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, mendoj se data 16  
12 ose data 23 prill për njoftimin, do të preferoja që të ishte data  
13 23 prill. Ndërkohë që sa i takon dosjes paraprake, do të propozoja  
14 datën 30 prill. Aktualisht, dosja paraprake është përcaktuar për  
15 datën 16 prill. Aktualisht, njoftimi është parashikuar për datën 6  
16 prill. Kështu që në qoftë se do të vendoset për datën 23, dhe në  
17 qoftë se do të kishte masa paraprake, atëherë do t'jua ngrija këtë  
18 çështje në kohën e duhur, dhe mbase mund të na duhet që ta bëjmë  
19 më përpara këtë seancë, p.sh., mund të ishte data 16. Pra, do të  
20 kërkoja këtë ndryshim sepse mendoj që pjesa më e madhe do të bëhet  
21 deri më datë 5, kështu që besoj që do të kemi një vlerësim të  
22 personave të cilët do të kenë nevojë të masave mbrojtëse.

23 Siç e thashë dhe më sipër, unë nuk parashikoj që të ketë  
24 nevojë për masa mbrojtëse, megjithatë, në qoftë se del e nevojshme  
25 një gjë e tillë pasi ne të bëjmë shqyrtimin e kujdesshëm, atëherë

1 do t'jua parashtrojmë, do t'jua bëjmë me dije këtë gjë.

2 Ndërkohë, që sa i takon njoftimit, mendoj që data 23 do të  
3 ishte data më e mirë. Pra, nuk e di në qoftë se mund ta shtyjme me  
4 dy javë, z. Gjykatës.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Von Bone.

6 Ju përmendët që në këtë fazë nuk parashikoni ndonjë kërkesë  
7 për masa mbrojtëse, apo jo?

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, është e vërtetë.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Dhe kjo është e vërtetë si për  
10 dëshmitarët e lidhur me alibinë dhe ata që nuk lidhen me alibinë,  
11 apo jo?

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, kështu është, z. Gjykatës.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Von Bone.

14 Nuk e di z. Prokuror, në qoftë se doni të shtoni diçka?

15 Z. MINICIS: [Përkthim] Po. Ne kemi një preferencë për  
16 Mbrojtjen, për dëshmitarët e alibisë që të përcaktohet më datë 16  
17 prill. E kuptojmë që Mbrojtja do të përfundojë misionin e saj në  
18 Kosovë në fillim të prillit, kështu që mendojmë që data 16 është e  
19 mjaftueshme dhe është një datë e arsyeshme edhe për Mbrojtjen.

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, e kuptoj këtë gjë, por keni  
21 parasysh që është dhe materiali që do të duhet të shqyrtohet pas  
22 kthimit nga vizita, do të duhet që të përgatishim materialin e  
23 nevojshëm. Besoj që më datën 5 unë do të kem një ide më të mirë sa  
24 i takon dëshmitarëve. Edhe në misione funksionon që ti nuk e di  
25 asnjëherë se çfarë të sjellë dita tjetër, kështu që do të ishte

1 mirë që të kishim pak kohë për të marrë frymë edhe për të  
2 përgatitur materialet siç duhet.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Von Bone.

4 Ndonjëra nga palët, dëshiron që të shtojë ndonjë gjë lidhur  
5 me këtë element, me këtë pikë të rendit të ditës? Mirë, atëherë.

6 Në këtë pikë do të doja që t'u kërkoja palëve që të shprehen  
7 në qoftë se ka ndonjë çështje tjetër për të ngritur.

8 Dua t'u kujtoj palëve që të njoftojnë paraprakisht në qoftë  
9 se ka parashtrime që kërkojnë nxjerrjen e informacionit  
10 konfidencial, në mënyrë që të mund të shkojmë në seancë me dyer të  
11 mbyllura.

12 Z. Prokuror, fjala për ju.

13 Z. MINICIS: [Përkthim] Faleminderit. Jo, i nderuar Gjykatës,  
14 nuk kemi çështje të tjera për të trajtuar.

15 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Von Bone.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, në fakt unë kam një çështje për  
17 të diskutuar, dhe do të doja që këtë çështje ta diskutonim me dyer  
18 të mbyllura dhe *ex parte*.

19 Dhe përpara sesa ta shtjelloj këtë çështje, do të doja të  
20 thosha diçka që dosja paraprake kërkohet më datë 30 prill, dhe në  
21 këtë rast ne do të jemi në gjendje që ta përfundojmë, ta  
22 përmbylim të gjithë punën që ka të bëjë me dosjen paraprake. Edhe  
23 besoj që prej kësaj date është më e thjeshtë për neve pastaj për  
24 të planifikuar datat e tjera.

25 Sa i takon Konferencës për Ecurinë e Çështjes, do të



1 preferoja që të ishte diku nga maji, do të doja që njerëzit të  
2 ishin të pranishëm. Për sa i takon pjesës procedurale, do të duhen  
3 shumë hapa të tjerë që të përmbushen në mënyrë që ata të jenë të  
4 pranishëm në Konferencën e ardhshme për Çështjen -- për Ecurinë e  
5 Çështjes Gjyqësore. P.sh., më datë 7 maj, ose ndonjë ditë e  
6 për afërt ndoshta, do të ishte një datë më e dobishme mendoj për  
7 këtë pikë.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Von Bone.

9 Përpara sesa të vijojmë më tej, do të doja që t'i kërkoja  
10 ZPS-së që të shprehej në qoftë se mendon që do të ishte e  
11 nevojshme që të kemi një tjetër Konferencë për Gjendjen Gjyqësore  
12 apo jo?

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, varet nga ju si  
14 do të vendosni, edhe varet edhe nga Mbrojtja. Në qoftë se ju  
15 dëshironi që të kemi një konferencë të tillë pas prillit, pa  
16 diskutim që nuk është se është ndonjë problem, ne mund të marrim  
17 pjesë. Ne se mendojmë një Konferencë të tillë për Ecurinë e  
18 Çështjes Gjyqësore të nevojshme, megjithatë, në qoftë se pala  
19 tjetër e konsideron këtë të nevojshme, jemi të gatshëm të marrim  
20 pjesë në të.

21 Z. VON BONE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, në qoftë se ka  
22 çështje që dalin gjatë punës në -- së planifikuar në vijim, do të  
23 njoftoj si Gjykatën ashtu edhe ZPS-së, edhe pastaj do të vazhdojmë  
24 sipas nevojës. Për mua d.m.th., duhet një Konferencë përmbyllëse  
25 për Ecurinë e Çështjes Gjyqësore për të shtjelluar gjërat,

1 çështjet të cilat do të dalin, megjithatë do të shohim sesi do të  
2 shkojë.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Do të doni që unë ta planifikoj  
4 Konferencën për Gjendjen Gjyqësore pasi apo përpara sesa ju të  
5 depozitoni dosjen paraprake?

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Pasi unë të depozitoj dosjen  
7 paraprake. Pra, në qoftë se ka çështje që mund të ngrihen  
8 ndërkohë, besoj që mund t'i trajtojmë në Konferencën e fundit për  
9 Ecurinë e Çështjes Gjyqësore.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit, z. Von Bone.

11 Do të bëjmë dy gjëra.

12 Pra, përpara sesa ta mbyllim tani, do të thosha që do të  
13 bëjmë një pushim të shkurtër prej dhjetë minutash, sepse Mbrojtja  
14 kërkoi një takim *ex parte*, dhe pastaj do të bëjmë një tjetër  
15 pushim pasi palët të takohen dhe do të bëjmë përmbylljen e ditës  
16 së sotme pas pushimit të dytë. Tani radha është pushimi dhjetë  
17 minuta, pastaj do të vijojmë me seancën *ex parte* siç u kërkua nga  
18 Mbrojtja.

19 Takimi ndërpritet.

20 --- Pauza fillon në orën 11.32

21

22

23

24

25

1  
2  
3  
4  
5  
6  
7  
8  
9  
10  
11  
12  
13  
14  
15  
16  
17  
18  
19  
20  
21  
22  
23  
24  
25

--- Rifillon në orën 12.25

GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Pasi dëgjova palët për kalendarin e propozuar, po e lëshoj këtë urdhër:

Deri të premten, 16 prill 2021, Mbrojtja urdhërohet të njoftojë ZPS-së për alibinë dhe të nxjerrë çdo material të mundshëm në bazë të rregullës 104(1)(a). Në qoftë se Mbrojtja dëshiron që t'i drejtohet Gjykatësit të Procedurës Paraprake me ndonjë kërkesë për masa mbrojtëse në lidhje me këtë material, duhet ta bëjë deri më 18 mars 2021(sic).

Të martën, 6 prill 2021(sic), Mbrojtja urdhërohet gjithashtu që të dorëzojë çdo kërkesë për masa mbrojtëse për dëshmitarë jo të alibisë.

Në përputhje me Vendimin Kuadër për nxjerrjen e materialeve për t'i lejuar Mbrojtjes të paraqesë çdo material rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* në version të redaktuar konfidencial të kërkesës apo kërkesa për masa mbrojtje.

ZPS-ja mund të përgjigjet, në qoftë se dëshiron, brenda pesë ditësh nga njoftimi i versionit konfidencial të redaktuar për çdo kërkesë.

Zyra e Mbrojtjes së Dëshmitarëve do të paraqesë vlerësimin e saj të rreziqeve lidhur me çdo dëshmitar për të cilin Mbrojtja kërkon masa mbrojtëse brenda pesë ditësh të njoftimit të një kërkesë të tillë.

Me ecurinë e hetimeve të Mbrojtjes, Mbrojtja mund t'i

1 drejtohet Gjyqtarit të Procedurës Paraprake apo Trupit Gjykues,  
2 sipas rastit, me kërkesa të tjera për masa mbrojtje -- mbrojtëse.

3 Deri në prill, 16 prill(sic), të premtën, Mbrojtja ftohet të  
4 dorëzojë dosjen paraprake dhe materialin e lidhur me të, sipas  
5 rregullës 95(5) të Rregullores, pa dëmtuar asnjë nga ndryshimet e  
6 mëtejshme të saj.

7 Duke qenë objekt i zgjidhjes së çdo problemi të mbetur,  
8 kalimi i dosjes së çështjes në -- Trupit Gjykues, pritet që të  
9 ndodhë në prill, 30 prill 2021(sic).

10 Gjithashtu, dëshiroj t'i organizoj çështjet lidhur me  
11 shqyrtimin tjetër të paraburgimit duke lëshuar urdhrat gojore me  
12 shkrim -- me gojë:

13 Mbrojtja e z. Mustafa duhet të paraqesë parashtrime nëse  
14 ekzistojnë apo jo arsyet për vazhdimin e paraburgimit deri më 11  
15 mars.

16 ZPS-ja duhet t'u përgjigjet këtyre parashtrimeve deri të  
17 mërkurën, 17 mars.

18 Çdo përgjigje duhet të ndjekë afatin e parashikuar në  
19 rregullën 76 të Rregullores.

20 Përpara se të përfundojmë dhe në vijim të rregullave që  
21 dhashë përpara për Zyrën e Administratës për të paraqitur një  
22 version publik të redaktuar të dosjes paraprake, dua të sqaroj se  
23 seanca e mbyllur për seancën e 14 dhjetorit 2020 hiqet, me  
24 përjashtim të redaktimeve që i përmenda më përpara.

1 Në qoftë se palët mendojnë se ka nevojë për një Konferencë  
2 tjetër për Ecurinë e Çështjes, ftohen që të bëjnë kërkesat e tyre.

3 Në këtë moment dëshiroj t'u drejtohem çështjeve -- palëve  
4 nëse kanë ndonjë çështje tjetër.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Nuk kemi ndonjë çështje të mbetur.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

7 Mbrojtësi, Von Bone.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk kemi as ne ndonjë çështje.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Me kaq përfundon seanca e  
10 sotme. Falënderoj palët, falënderoj përkthyesit, stenografët,  
11 teknikët, punonjësit e sigurisë për ndihmën e tyre.

12 Seanca mbyllet këtu.

13 --- Konferenca për Ecurinë e Çështjes përfundoi në  
14 orën 12.30

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25